

EDICIONI I DYTË

BULETINI INFORMATIV

(prill, maj, qershor)



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY



AKK SHQIPTON GJOBA NË NJË NGA RASTET MË TË MËDHA QË NGA THEMELIMI

Një nga rastet më të rëndësishme që Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka trajtuar që nga themelimi, i njohur gjerësisht në media si “Rasti Nafta”, ka përfunduar në fillim të muajit maj.

Një masë ndëshkuese administrative në vlerë prej mbi 4 milionë euro është shqiptuar ndaj 14 kompanive të derivateve të naftës, të cilat kanë qenë nën hetim që nga viti 2019 për shkelje të rregullave të konkurrencës.

Hetimi i AKK-së ka vërtetuar se kompanitë e gjobitura nuk kanë reflektuar në mënyrë individuale me rastin e caktimit të çmimeve gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018, kur dominonte dyshimi se çmimi i derivateve në tregun e Kosovës kishte mbetur i njëjtë përkundër uljes së çmimit në berzën ndërkombëtare.

Në një konferencë për media të mbajtur për të shpalosur vendimin, Kryetari i AKK-së Valon Prestreshi ka kërkuar nga kompanitë që të ndalojnë çdo veprim që ka të bëjë me përcaktimin e çmimeve në mënyrë të bashkërenduar, përmes çfarëdo marrëveshjeje apo bashkëpunimi tjetër joformal, i cili mund të shkojë në dëm të konsumatorëve dhe çrregullon konkurrencën.





AUTORITETI I KONKURRENCËS GJATË PANDEMISË

Ashtu sikur shumica e institucioneve të Kosovës, edhe Autoriteti i Konkurrencës ka punuar me kapacitet më të kufizuar për shkak të rrethanave të krijuara nga përhapja e pandemisë COVID-19.

Sidoqoftë, zyrtarët të AKK-së kanë vazhduar monitorimin sistematik të tregut, me theks të veçante për të bërë monitorimin e çmimeve të produkteve esenciale gjatë periudhës së pandemisë. Në muajin prill, AKK ka njoftuar se ka evidentuar dyshime për shkelje të konkurrencës në disa raste që kanë të bëjnë me shitjen e dezinfektuesve dhe alkoolit për përdorim mjekësor.

Më 12 mars, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Valon Prestreshi, ishte emëruar nga Qeveria e Kosovës si pjesë e një Komisioni të Posaçëm për parandalimin e pandemisë, ku kanë qenë të përfshira edhe institucione të tjera të rëndësishme të vendit.

Poashtu, gjatë kësaj periudhe AKK ka zhvilluar edhe një fushatë vetëdijesuese për qytetarët dhe sektorin e biznesit lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrë që të parandalohen çfarëdo shkelje të rregullave të konkurrencës në treg.

Disa aktivitete të cilat janë pjesë e Projektit “Përkrahja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore” janë zhvilluar kurse për disa të tjera janë bërë përgatitjet në mënyrë që të zhvillohen sapo të krijohen kushtet normale të punës.

Duhet theksuar po ashtu se sapo AKK ka rifilluar punën nga zyret, është obliguar që të rikthehet për së paku dy javë në punën nga shtëpitë meqë disa nga zyrtarët kanë rezultuar pozitiv me koronavirus.

KOMISIONI PARLAMENTAR MIRATON RAPORTIN VJETOR TË AKK-SË



Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, ka miratuar me shumicë dërmuese raportin e punës së AKK-së për vitin 2019 në muajin maj.

Votimit për këtë raport i ka paraprirë një sesion pyetjesh të deputetëve të këtij komisioni, të cilave u janë përgjigjur drejtuesit e AKK-së dhe Kryetari Prestreshi. Kuvendi i Kosovës zgjedh drejtuesit e AKK-së dhe është organ mbikëqyrës i punës së Autoritetit.

Gjatë muajit maj, drejtuesit e Autoritetit po ashtu kanë zhvilluar një takim me Kryetaren e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, me të cilën ndër të tjerash kanë diskutuar për reagimin e Autoritetit gjatë përhapjes së pandemisë COVID-19.

Osmani ka falënderuar Autoritetin për reagimin e shpejt dhe komunikimin e vazhdueshëm me qytetarët në lidhje me çështjen e rritjes së çmimeve të produkteve esenciale në treg gjatë periudhës së përballjes me koronavirusin.

Ata kanë diskutuar edhe për vendimin e AKK-së në lidhje me “Rastin Nafta”.

AKK DHE AUTORITETET E NDIHMËS SHTETËRORE DISKUTOJNË TEMA ME INTERES TË PËRBASHKËT

Autoriteti Kosovari i Konkurrencës dhe autoritetet e ndihmës shtetërore në Kosovë, më konkretisht Komisioni i Ndihmës Shtetërore dhe Departamenti i Ndihmës Shtetërore, kanë zhvilluar një takim në fillim të qershorit.

Takimi - që është organizuar me ndihmën e Projektit Përkrahja e BE-së për Autoritetin Kosovari të Konkurrencës dhe Komisionit të Ndihmës Shtetërore - është shfrytëzuar për diskutimin e një numri të temave konkrete me interes të përbashkët për të tre këto institucione.

Drejtori i Përgjithshëm i AKK-së, Sakip Imeri, dhe nënkryetari Ahmet Krasniqi kanë mirëpritur këtë takim, duke thënë se bashkëpunimi në mes të autoriteteve është i domosdoshëm. Që të dy kanë shprehur gatishmërinë e AKK-së për bashkërendimin e aktiviteteve për çështje me interes të përbashkët.



AUDITORI NUK GJEN VËREJTJE NË PUNËN E AUTORITETIT GJATË VITIT 2019



Autoriteti i Konkurrencës nuk ka pranuar vërejtje nga Zyra e Auditorit lidhur me punën dhe menaxhimin e financave gjatë vitit 2019.

Sipas Auditorit, pasqyrat financiare për vitin 2019 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Për më tepër, Auditori i Përgjithshëm poashtu ka konstatuar se Autoriteti i Konkurrencës ka arritur që të përmbushë rekomandimet që kanë dalë nga raporti i vitit 2018.



FILLON SHQYRTIM PARAPRAK I TENDERËVE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË

Divizioni Anti-kartel i Autoritetit të Konkurrencës ka filluar shqyrtimin paraprak të fakteve lidhur me tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë të zhvilluar gjatë periudhës së pandemisë.

Një gjë e tillë ka ndodhur pasi Ministria e Shëndetësisë u kishte bërë thirrje publike disa institucioneve të Kosovës, përfshirë edhe Autoritetin e Konkurrencës, që të hetojnë çdo shkelje të mundshme në procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga kjo ministri gjatë përballjes me pandeminë COVID-19.

Divizioni në fjalë i AKK-së tashmë ka pranuar dosjet nga Ministria e Shëndetësisë. Lidhur me këtë rast, AKK do ta orientojë pistën hetimore tek aspekti i “bid rigging”, apo manipulimi me oferta.

Grupi punues i formuar për të trajtuar këtë rast do të shqyrtojë të gjitha të dhënat e siguruara, dhe do të bëjë publike çdo zhvillim lidhur me këtë çështje sapo të përfundojnë të gjitha procedurat e parapara me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

AKK

I OFRON REKOMANDIM PROFESIONAL QEVERISË PËR RASTIN E TELEKOMIT

Autoriteti i Konkurrencës avokon për një mjedis konkurrues ku garantohet se do të ketë garues për të prodhuar një produkt apo për të ofruar një shërbim. Një gjë e tillë bëhet edhe përmes ofrimit të mendimeve profesionale autoriteteve qendrore apo lokale në Kosovë, në mënyrë që të evitohen shkeljet e mundshme të konkurrencës.

Në këtë kontekst, në fillim të muajit prill, Komisioni i AKK-së ka vendosur që t'i rekomandojë Qeverisë së Kosovës që ta rishikojë një vendim të datës 02.04.2020 nr 05/21, me të cilin përjashton Ligjin e Prokurimit për shërbimet telekomunikuese që i ofron Telekomit i Kosovës.

Sipas Komisionit, një vendim i tillë dobëson presionin konkurrues dhe mund të shpie tek format e keqpërdorimit të pozitës dominuese nga ana e Telekomit të Kosovës.

AKK ka vlerësuar se përmes këtij vendimi, Qeveria e Kosovës i ka përjashtuar ofertat që mund t'i ofrojnë ndërmarrjet për shërbime telekomunikuese dhe duke e bërë monopol natyror Telekomit.

QEVERIA PËRFSHINË LIGJIN E RI TË KONKURRENCËS NË PROGRAMIN LEGJISLATIV 2020



Qeveria e Kosovës e ka përfshirë ligjin e ri të Konkurrencës në programin legjislativ për vitin 2020. Fillimisht, Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës ishte miratuar në vitin 2010, për t'u ndryshuar pastaj me Ligjin e vitit 2014. Drejtuesit e AKK-së kanë mirëpritur futjen e këtij ligji në agjendën legjislative për vitin 2020 duke besuar se ky ligj mundëson përmirësimin e punës së AKK-së në disa aspekte.

Gjatë muajit korrik, zyrtarët e AKK-së do të mbajnë një punëtori disa ditore me Projektin Mbështetja e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndhmës Shtetërore” për të analizuar në detaje ligjin.

Viteve të fundit, AKK ka qenë e angazhuar për përfundimin e plotë të ndryshimeve ligjore duke u bazuar në praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY



EU Support to the Kosovo Competition Authority and the State Aid Commission



"Ky buletin është përkrahur nga Projekti EU Support to the Kosovo Competition Authority and State Aid Commission. Përmbajtja e tij është përpiluar në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, dhe është përgjegjësi e tyre dhe e B&S Europe dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian"

(PRILL, MAJ, QERSHOR)